



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Ministarstvo Rada i Socijalne Zaštite
Ministry of Labour and Social Welfare

STANDARDET MINIMALE DHE SPECIFIKIMI I SHËRBIMEVE:

ADOPTIMI I FËMIJËVE PA PËRKUJDESJE PRINDËRORE

Udhëzuesi Numër 3

Korniza e shërbimit dhe Standardet minimale Adoptimi i fëmijëve pa përkujdesje prindërore

1. Hyrje

Ky udhëzues duhet të lexohet së bashku me Kornizën e Shërbimit dhe fletën e përshtatshmërisë (përputhshmërisë) për këtë shërbim.

Ky udhëzues, po ashtu duhet të pilotohet (testohet) në të njëjtën kohë kur bëhet edhe pilotimi i standardeve. Ky udhëzues është zhvilluar që:

- të ofrojë mbështetje për ofruesit e shërbimeve, për t'i vënë në vend mjetet dhe proceset, dokumentet dhe sistemet, për ta arritur matjen dhe zbatimin e standardeve, dhe
- t'i asistojë ofruesit e shërbimeve për ta përmirësuar cilësinë e shërbimeve që ata i ofrojnë

Udhëzuesi ofron udhëzime dhe informata lidhur me atë se, si të kompletohen dokumentet dhe proceset e nevojshme për ta mbështetur monitorimin e përputhshmërisë me standardet e dakorduara. Këto dokumente janë mjete (vegla) për matjen e standardeve pavarësisht se a janë arritur apo jo standardet. Është menduar që nëpërmjet këtij procesi të pilotimit, të këtij udhëzuesi dhe vetë standardeve, këto dokumente dhe procese ose të përmirësohen, ose të identifikohen procese më të mira, të cilat mund të përfshihen në versionin final të këtij udhëzuesi

2. Korniza e shërbimit

Korniza e shërbimit për shërbimin e dhunës në familje, përmban pjesët në vijim:

- Qëllimi i shërbimeve të dhunës në familje – i përcakton qëllimet kryesore të shërbimit
- Grupet prioritare – e përcaktojnë atë se kush ka të drejtë në shfrytëzimin e shërbimit
- Specifikimi i shërbimit - detajet e aktiviteteve të cilat janë të përfshira në ofrimin e shërbimit:
 - Identifikimi i fëmijës
 - pranimi
 - vlerësimi
 - planifikimi
 - asistenca e posaçme e ofruar (p.sh., menaxhimi i sjelljes)
 - mbështetja e rregullt dhe mbikëqyrja
 - angazhimi (lidhja) me fëmijën dhe familjen adoptuese
- standardet minimale strukturale dhe funksionale

3. Standardet minimale strukturale dhe funksionale--Definicionet

Standardet strukturale: Deklarata të dakorduara të cilat i identifikojnë kërkesat strukturale të shërbimit

Standardet funksionale: Deklarata të cilat i definojnë kriteret për matjen e proceseve dhe aktiviteteve të shërbimit në arritjen e qëllimit të shërbimit

Për shërbimet e dhunës në familje, standardet strukturale janë identifikuar për:

- organizatën
- personelin
- trajnimin

Për këtë shërbim, standardet funksionale janë vënë për:

- pranimin dhe vlerësimin
- planifikimin dhe rishikimin
- monitorimin

Aty ku e mundur, janë definuar indikatorët e performancës për standardet

Indikator i performancës: Një formulë e thjeshtë që përfshinë dy (apo 3) pjesë të të dhënave (performanca aktuale / performanca e kërkuar), të cilat do të lejojnë për një sistem elektronik apo të bazuar në letër për procesim të lehtë dhe përputhshmëri monitorimi, të shprehur si përqindje.

4. Fleta e përshtatshmërisë së standardeve (fleta në excel për monitorimin e përshtatshmërisë me standardet)

Sa i përket vlerësimit të përshtatshmërisë me standardet minimale, procesi është relativisht i kuptueshëm. Programi i mbledhjes së të dhënave në excel është një tabelë e thjeshtë elektronike në excel, që po ashtu mund të procedohet manualisht në letër. Në krye të tabelës, e identifikon:

- shërbimin, ofruesin e shërbimit, dhe lokacionin e ofruesit të shërbimit;
- personin hallkë në shërbimin që ofron informatat në fletën e mbledhjes së të dhënave;
- periudhën e mbuluar nga fleta e përshtatshmërisë.

Fleta në excel i ka 12 kolona:

Kolona 1: Numri referues është rrjedha e tre numrave (e definojnë secilin shërbim, llojin e standardit dhe çdo standard individual) p.sh. 3.1.1 apo 3.2.1. Numri i parë (3.1.1) – e bën identifikimin se këtu e kemi shërbimin e adoptimit për fëmijë dhe personat e rinj; Numri i dytë 1 (3.1.1) – e specifikon se, ky është një standard struktural; derisa numri i dytë 2 (3.2.1) do ta identifikojë standardin struktural. Numri i tretë (3.2.1) do ta identifikojë standardin specifik, në këtë rast, së pari standardin funksional.

Kolona 2: Çdo standard individual struktural dhe funksional.

Kolona 3: Formula e indikatorit të performancës, ku një është definuar (kjo është e domosdoshme për versionin elektronik).

- Kolona 4: Performanca aktuale e ofruesit në raport me standardin (shprehur në numra)
- Kolona 5: Performanca e kërkuar e standardit (shprehur në numra). *Shih shënimin më poshtë lidhur me indikatorët e performancës me tri të dhëna.
- Kolona 6: Niveli relevant i përshtatshmërisë me standardin e shprehur në përqindje (%).
- Kolona 7-9: Në qoftë se, nuk ka indikator të performancës të identifikuar për atë standard, atëherë një tjetër metodë monitoruese duhet të përdoret:
- mbledhja e të dhënave (kur është identifikuar indikatori i performances
 - mbikëqyrja apo
 - observimi.
- Është e mundur që të përdoret më shumë se një metodë
- Kolona 10: Një deklaratë e thjeshtë se a është arritur standardi apo jo (Po/Jo).
- Kolona 11: Arsyeja e identifikuar nga ofruesi i shërbimit për mos arritjen e standardit kur standardi nuk është arritur.
- Kolona 12: Propozimi i ofruesit të shërbimit për veprimin e kërkuar në raport me standardin që nuk është arritur.

*Indikatorët e performancës duke përdorë tri të dhëna, kërkesa është identifikuar nga numri i tretë (i fundit) në formulën e indikatorit të performancës. Numri i fundit është i pranishëm në Kolonën 5. Rezultati i ndarjes së numrit të parë me numrin e dytë është se atëherë vendoset në Kolonën 4.

Sa i përket kompletimit të fletës së përshtatshmërisë, ofruesi i shërbimit duhet ta shënjojë kolonën 7-9 varësisht për atë se për çka është përdorë monitorimi. Përveç kësaj, ofruesi i shërbimit duhet ta vejë “Po” apo “jo” në kolonën 10. Kur përgjegjia është “jo” ju lus, ta vëni arsyen për përgjegjien “jo” duke përdorë kodet e ofruara N. Ofruesi, atëherë duhet t’i identifikojë disa veprime të cilat kërkojnë për ta mundur që standardi të arrihet duke i përdorur kodet e ofruara R.

Për kolonën 11 dhe 12 janë identifikuar kode të thjeshta:

- arsyeja kryesore për mos arritjen e standardit (p.sh., “kohë e pamjaftueshme”, apo “mungesa e bashkërendimit me agjencitë e tjera”), dhe
- veprimi i përshtatshëm i kërkuar në qoftë se standardi nuk është arritur.

Në vijim, janë përcaktuar kodet të cilat janë zhvilluar.

J Kodet	Arsyeja për mospërshtatshmëri apo përshtatshmëri të pjesshme me standardet
J1	Koha jo e mjaftueshme e kaluar me shfrytëzuesin e shërbimit
J2	Mungesa e stafit
J3	Shkathtësitë e reja të kërkuara nga stafi
J4	Bashkërendimi i dobët me agjencitë e tjera
J5	Planifikimi i dobët i shërbimeve
J6	Mbikëqyrje jo e mjaftueshme

J7	Bashkëpunim me ndërprerje me shfrytëzuesin e shërbimit
J8	Hapësira të papërshtatshme për ofrimin e shërbimit
J9	Burime të pamjaftueshme financiare
J10	Mungesa e procedurave të brendshme që lejojnë matjen e përshtatshmërisë
J11	Standard joreal dhe jo i arritshëm
J12	Shëndeti i dobët i klientit
J13	Vdekja e shfrytëzuesit të shërbimit
J14	Mungesa e hapësirave të gjelbëruara
J15	Administrimi jo i përshtatshëm
R Kodet	Veprimi i propozuar i ofruesit (Reagimi) pas jo përshtatshmërisë me standardin
R1	Amendament për ta bërë standardin më real
R2	Përmirësim i shkathtësive të profesionistëve për ta arritur standardin
R3	Sisteme të përmirësuara për ta matur përshtatshmërinë
R4	Bashkërendim më i mirë me agjencitë e tjera
R5	Sisteme të përmirësuara të planifikimit të shërbimeve
R6	Mbikëqyrje e përmirësuar
R7	Vlerësim më i mire për të siguruar bashkëpunimin me shfrytëzuesin e shërbimit
R8	Hapësira fizike të përmirësuara për ofrimin e shërbimeve
R9	Burime të shtuara financiare
R10	Programe të reja trajnuese për t'u krijuar apo akredituar

5. Vlerësimi dhe regjistrimi i përshtatshmërisë me standardet minimale strukturale

5.1.1 Secili shërbim i adoptimit duhet të ketë së paku një jurist, një punëtor social, një pedagog, një psikolog, dhe një sociolog.

Indikatori i performancës nuk është caktuar, kështu që ky standard mund të vlerësohet nëpërmjet të observimit apo mbikëqyrjes. Në qoftë se, ky standard është përmbushur vetëm pjesërisht, duhet treguar me “jo” dhe kodi i përshtatshëm i zgjedhur për papërshtatshmëri.

5.1.2 Secili shërbim i adoptimit duhet të ketë qasje tek një mjek

Indikatori i performancës nuk është caktuar, kështu që ky standard mund të vlerësohet nëpërmjet të observimit apo mbikëqyrjes. Në qoftë se, ky standard është përmbushur vetëm pjesërisht, duhet treguar me “jo” dhe kodi i përshtatshëm i zgjedhur për papërshtatshmëri.

5.1.3 Ekipi do të ketë qasje tek një punëtor social me përvojë të punës në spital

Indikatori i performancës nuk është caktuar, kështu që ky standard ka mund të vlerësohet nëpërmjet të observimit apo mbikëqyrjes. Në qoftë se, ky standard është përmbushur vetëm pjesërisht, duhet treguar me “jo” dhe kodi i përshtatshëm i zgjedhur për papërshtatshmëri.

5.1.4 Secili menaxher i rastit do t'i ketë maksimum 3 fëmijë për adoptim në çdo vit

Indikatori i performancës për këtë standard është vendosur. Kjo do të thotë se dy anët (pjesët) e informacionit duhet të mblidhen.

- 1) Numri i menaxherëve të rastit, pjesëtuar me numrin e fëmijëve
- 2) numrin e fëmijëve 3

Rezultati 1) duhet të vihet në kolonën 4, 2) tanimë është në kolonën 5. Kolona 6: niveli i përshtatshmërisë është automatik, në qoftë se, përdoret tabela e excelit e cila është e vendosur për ta nxjerrë përqindjen, duke treguar nivelin e përshtatshmërisë. Për sistemet e bazuara në letër, ky numër duhet të llogaritet në mënyrë manuale.

5.1.5 Secili ekip i shërbimit të adoptimit do të jetë i përzier sa i përket gjinisë, duke angazhuar edhe meshkuj edhe femra

Indikatori i performancës nuk është caktuar, kështu që ky standard mund të vlerësohet nëpërmjet të observimit apo mbikëqyrjes. Në qoftë se, ky standard është përmbushur vetëm pjesërisht, duhet treguar me "jo" dhe kodi i përshtatshëm i zgjedhur për papërshtatshmëri.

5.1.6 Një dhomë për intervistim do të jetë në disponim për shfrytëzimin e shërbimit me intervisitmin e fëmijëve, prindërve adoptues dhe prindërve natyral

Indikatori i performancës nuk është caktuar, kështu që ky standard mund të vlerësohet nëpërmjet të observimit apo mbikëqyrjes. Në qoftë se, ky standard është përmbushur vetëm pjesërisht, duhet treguar me "jo" dhe kodi i përshtatshëm i zgjedhur për papërshtatshmëri.

5.1.7 Secili anëtar i ekipit do të ketë qasje në teknologjinë informative e cila e mbështetë punën e ekipit, përfshirë një kompjuter, një printer, skanerin dhe qasjen në internet

Indikatori i performancës nuk është caktuar, kështu që ky standard ka mund të vlerësohet nëpërmjet të observimit apo mbikëqyrjes. Në qoftë se, ky standard është përmbushur vetëm pjesërisht, duhet treguar me "jo" dhe kodi i përshtatshëm i zgjedhur për papërshtatshmëri.

5.1.8 Secili shërbim regjional do të ketë qasje në së paku 2 vetura, për ta mbështetur punën e vetë.

Indikatori i performancës nuk është caktuar, kështu që ky standard mund të vlerësohet nëpërmjet të observimit apo mbikëqyrjes. Në qoftë se, ky standard është përmbushur vetëm pjesërisht, duhet treguar me "jo" dhe kodi i përshtatshëm i zgjedhur për papërshtatshmëri.

5.1.9 Secili shërbim në komunat e vogla do të ketë qasje në së paku një veturë për ta mbështetur punën e vetë.

Indikatori i performancës nuk është caktuar, kështu që ky standard mund të vlerësohet nëpërmjet të observimit apo mbikëqyrjes. Në qoftë se, ky standard

është përmbushur vetëm pjesërisht, duhet treguar me “jo” dhe kodi i përshtatshëm i zgjedhur për përshtatshmëri.

6. Vlerësimi dhe regjistrimi i përshtatshmërisë me standardet minimale funksionale

6.2.1 Secili fëmijë i konsideruar për adoptim potencial do ta ketë një menaxher të caktuar të rastit

Indikatori i performancës për këtë standard është vendosur. Kjo do të thotë se dy anët (pjesët) e informacionit duhet të mblidhen.

- 1) Numri i fëmijëve me menaxherë të caktuar të rastit, pjesëtuar me
- 2) numrin e fëmijëve

Këta numra duhet të vihen në kolonën 4 dhe 5 respektivisht. Kolona 6: niveli i përshtatshmërisë është automatik, në qoftë se, përdoret tabela e excelit e cila është e vendosur për ta nxjerrë përqindjen, duke treguar nivelin e përshtatshmërisë. Për sistemet e bazuara në letër, ky numër duhet të llogaritet në mënyrë manuale.

6.2.2 Secili fëmijë i konsideruar për adoptim potencial do ta ketë një kujdestar të caktuar ligjor

Indikatori i performancës për këtë standard është vendosur. Kjo do të thotë se dy anët (pjesët) e informacionit duhet të mblidhen.

- 1) Numri i fëmijëve me kujdestarë të caktuar ligjor, pjesëtuar me
- 2) numrin e fëmijëve

Këta numra duhet të vihen në kolonën 4 dhe 5 respektivisht. Kolona 6: niveli i përshtatshmërisë është automatik, në qoftë se, përdoret tabela e excelit e cila është e vendosur për ta nxjerrë përqindjen, duke treguar nivelin e përshtatshmërisë. Për sistemet e bazuara në letër, ky numër duhet të llogaritet në mënyrë manuale.

6.2.3 Në secilin rast të braktisjes potenciale, informatat do të ndahen me profesionistë të përshtatshëm të departamentit të mirëqenies sociale brenda 24 orëve nga koha e referimit të rastit.

Indikatori i performancës për këtë standard është vendosur. Kjo do të thotë se dy anët (pjesët) e informacionit duhet të mblidhen

- 1) Numri i ndarjes së informatave brenda 24 orëve të referimit, pjesëtuar me
- 2) numrin e fëmijëve të referuar

Këta numra duhet të vihen në kolonën 4 dhe 5 respektivisht. Kolona 6: niveli i përshtatshmërisë është automatik, në qoftë se, përdoret tabela e excelit e cila është e vendosur për ta nxjerrë përqindjen, duke treguar nivelin e përshtatshmërisë. Për sistemet e bazuara në letër, ky numër duhet të llogaritet në mënyrë manuale.

- 6.2.4 Secili fëmijë do ta ketë një plan individual të punës për rastin i cili do të përgatitet pas një vlerësimi fillestar dhe brenda 2 javëve të referimit

Indikatori i performancës për këtë standard është vendosur. Kjo do të thotë se dy anët (pjesët) e informacionit duhet të mblidhen.

- 1) Numri i fëmijëve me planet individuale të përkujdesjes të bëra brenda dy javëve të vlerësimit, pjesëtuar me
- 2) numrin e fëmijëve të vlerësuar

Këta numra duhet të vihen në kolonën 4 dhe 5 respektivisht. Kolona 6: niveli i përshtatshmërisë është automatik, në qoftë se, përdoret tabela e excelit e cila është e vendosur për ta nxjerrë përqindjen, duke treguar nivelin e përshtatshmërisë. Për sistemet e bazuara në letër, ky numër duhet të llogaritet në mënyrë manuale.

- 6.2.5 Plani i rastit individual për secilin fëmijë do të rishikohet së paku një here në muaj

Indikatori i performancës për këtë standard është vendosur. Kjo do të thotë se dy anët (pjesët) e informacionit duhet të mblidhen

- 1) Numrin e fëmijëve me planet e rastit të rishikuara çdo muaj, pjesëtuar me
- 2) numrin total të fëmijëve me planet e rastit

Këta numra duhet të vihen në kolonën 4 dhe 5 respektivisht. Kolona 6: niveli i përshtatshmërisë është automatik, në qoftë se, përdoret tabela e excelit e cila është e vendosur për ta nxjerrë përqindjen, duke treguar nivelin e përshtatshmërisë. Për sistemet e bazuara në letër, ky numër duhet të llogaritet në mënyrë manuale.

- 6.2.6 Vlerësimi i prindërve potencial adoptues dhe familjes do të bëhet brenda 3 muajve

Indikatori i performancës për këtë standard është vendosur. Kjo do të thotë se dy anët (pjesët) e informacionit duhet të mblidhen.

- 1) Numri i familjeve potenciale adoptuese të vlerësuara gjatë periudhës 3 mujore të vlerësimit, pjesëtuar me
- 2) numrin total të familjeve potenciale adoptuese të vlerësuara

Këta numra duhet të vihen në kolonën 4 dhe 5 respektivisht. Kolona 6: niveli i përshtatshmërisë është automatik, në qoftë se, përdoret tabela e excelit e cila është e vendosur për ta nxjerrë përqindjen, duke treguar nivelin e përshtatshmërisë. Për sistemet e bazuara në letër, ky numër duhet të llogaritet në mënyrë manuale.

- 6.2.7 Trajnimi i prindërve potencial adoptues dhe familjes do të bëhet pas vlerësimit dhe bazuar në nevojat e tyre

Indikatori i performancës për këtë standard është krijuar. Kjo nënkupton se dy pjesë të informacionit duhet të mblidhen.

- a) Numri i familjeve adoptuese të trajnuara pas periudhës së vlerësimit, pjesëtuar me

b) Numrin e përgjithshëm të familjeve adoptuese të trajnuara

Këta numra duhet të futen në kolonën 4 dhe 5 respektivisht. Kolona 6: niveli i përshtatshmërisë automatikisht po qe se përdorë tabelën e excelit që është vendosur për ta nxjerrë përqindjen, duke treguar nivelin e përshtatshmërisë. Për sistemet e bazuara në letër, ky numër do të duhet të llogaritet në mënyrë manuale.

6.2.8 Së paku dy nga takimet vlerësuese me prindërit adoptues do të jenë pa paralajmërim paraprak

Indikatori i performancës nuk është caktuar, kështu që ky standard ka mund të vlerësohet nëpërmjet të observimit apo mbikëqyrjes. Në qoftë se, ky standard është përmbushur vetëm pjesërisht, duhet treguar me “jo” dhe kodi i përshtatshëm i zgjedhur për papërshtatshëm.

6.2.9 Prindërit adoptues do të intervistohen dhe vlerësohen ndaras, së paku një herë gjatë fazës së vlerësimit

Indikatori i performancës nuk është caktuar, kështu që ky standard ka mund të vlerësohet nëpërmjet të observimit apo mbikëqyrjes. Në qoftë se, ky standard është përmbushur vetëm pjesërisht, duhet treguar me “jo” dhe kodi i përshtatshëm i zgjedhur për papërshtatshëm.

6.2.10 Fëmijët natyral mbi moshën 10 vjeçare brenda familjes së prindërve adoptues do të intervistohen ndaras, së paku një herë gjatë fazës së vlerësimit

Indikatori i performancës nuk është caktuar, kështu që ky standard ka mund të vlerësohet nëpërmjet të observimit apo mbikëqyrjes. Në qoftë se, ky standard është përmbushur vetëm pjesërisht, duhet treguar me “jo” dhe kodi i përshtatshëm i zgjedhur për papërshtatshëm.

6.2.11 Rivlerësimi i prindërve të aprovuar adoptues të cilët ende nuk e kanë marrë fëmijën duhet të bëhet së paku një herë në vit

Indikatori i performancës për këtë standard është vendosur. Kjo do të thotë se dy anët (pjesët) e informacionit duhet të mblidhen.

- 1) Numri i rivlerësimeve të prindërve të aprovuar adoptues pa fëmijën e vendosur në adoptim, pjesëtuar me
- 2) numrin e prindërve të aprovuar adoptues për rreth një vit pa vendosje të fëmijës

Këta numra duhet të vihen në kolonën 4 dhe 5 respektivisht. Kolona 6: niveli i përshtatshmërisë është automatik, në qoftë se përdoret tabela e excelit e cila është e vendosur për ta nxjerrë përqindjen duke treguar nivelin e përshtatshmërisë. Për sistemet e bazuara në letër, ky numër duhet të llogaritet në mënyrë manuale.

6.1.12 Secila familje potenciale adoptuese do t'i ketë së paku 3 takime këshilluese lidhur me çështje të rëndësishme që kanë të bëjnë me adoptimin e fëmijës.

Indikatori i performancës për këtë standard është vendosur. Kjo do të thotë se dy anët (pjesët) e informacionit duhet të mblidhen.

- 1) *Numri i familjeve adoptuese që kanë pasur 3 apo më shumë takime këshilluese gjatë periudhës së vlerësimit, pjesëtuar me*
- 2) *numrin e familjeve të vlerësuara adoptuese*

Këta numra duhet të vihen në kolonën 4 dhe 5 respektivisht. Kolona 6: niveli i përshtatshmërisë është automatik, në qoftë se, përdoret tabela e excelit e cila është e vendosur për ta nxjerrë përqindjen, duke treguar nivelin e përshtatshmërisë. Për sistemet e bazuara në letër, ky numër duhet të llogaritet në mënyrë manuale.

6.1.13 Do të jenë së paku 3 vizita për fëmijën, në përgatitje për vendosje me familjen adoptuese

Indikatori i performancës për këtë standard është vendosur. Kjo do të thotë se dy anët (pjesët) e informacionit duhet të mblidhen.

- 1) *Numri i fëmijëve të cilët janë takuar 3 apo më shumë herë në takime përgatitore, pjesëtuar me*
- 2) *numrin e fëmijëve të cilët janë përgatitur për adoptim*

Këta numra duhet të vihen në kolonën 4 dhe 5 respektivisht. Kolona 6: niveli i përshtatshmërisë është automatik, në qoftë se, përdoret tabela e excelit e cila është e vendosur për ta nxjerrë përqindjen, duke treguar nivelin e përshtatshmërisë. Për sistemet e bazuara në letër, ky numër duhet të llogaritet në mënyrë manuale.

6.1.14 Do të jenë së paku 3 vizita të cilat do t'i bëhen fëmijës dhe prindërve adoptues gjatë fazës paraadoptuese të vendosjes

Indikatori i performancës për këtë standard është vendosur. Kjo do të thotë se dy anët (pjesët) e informacionit duhet të mblidhen.

- 1) *Numri i fëmijëve dhe prindërve adoptues që vizitohen 3 apo më shumë herë gjatë fazës paraadoptuese, pjesëtuar me*
- 2) *numrin e fëmijëve të vendosur për adoptim*

Këta numra duhet të vihen në kolonën 4 dhe 5 respektivisht. Kolona 6: niveli i përshtatshmërisë është automatik, në qoftë se, përdoret tabela e excelit e cila është e vendosur për ta nxjerrë përqindjen, duke treguar nivelin e përshtatshmërisë. Për sistemet e bazuara në letër, ky numër duhet të llogaritet në mënyrë manuale.

6.1.15 Secili fëmijë do të vizitohet në shtëpinë adoptuese së paku 2 herë gjatë 12 muajve pas vendimit final të adoptimit

Indikatori i performancës për këtë standard është vendosur. Kjo do të thotë se dy anët (pjesët) e informacionit duhet të mblidhen

- 1) Numri i fëmijëve të cilët vizitohen 2 apo më shumë herë pas adoptimit brenda 12 muajve të vendimit të adoptimit, pjesëtuar me
- 2) numrin e fëmijëve të adoptuar

Këta numra duhet të vihen në kolonën 4 dhe 5 respektivisht. Kolona 6: niveli i përshtatshmërisë është automatik, në qoftë se përdoret tabela e excelit e cila është e vendosur për ta nxjerrë përqindjen duke treguar nivelin e përshtatshmërisë. Për sistemet e bazuara në letër, ky numër duhet të llogaritet në mënyrë manuale.

3- Korniza e shërbimit dhe standardet minimale Adoptimi i fëmijëve pa përkujdesje prindore

Qëllimi i shërbimit të adoptimit

Qëllimi i shërbimit të adoptimit është që t'ua mundësojë fëmijëve të braktisur që ta përjetojnë sigurinë ligjore dhe lidhshmërinë emocionale brenda familjes, që është esenciale për cilësinë e jetës së tij/saj si fëmijë dhe më vonë si një i/e rritur.

Grupet prioritare

Shërbimet e adoptimit i adresojnë nevojat e tri grupeve

- Fëmijët nën moshën 18 vjeçare të cilët janë braktisur apo janë në rrezik të braktisjes
- Prindërit e ardhshëm adoptues (me njërin apo të dy të moshës 50 vjeçare apo më pak)
- Prindi/ërit natyror të fëmijëve në rrezik

Parimet e shërbimit të adoptimit

- ✓ Secili fëmijë ka të drejtë të jetojë në familje
- ✓ Secili fëmijë ka të drejtë ta dijë historinë e tij/saj personale
- ✓ I gjithë informacioni lidhur me fëmijën dhe familjen e tij/saj do të mbetet konfidencial për shërbimin, përveç nëse fëmija apo prindi pajtohet që ky informacion të ndahet me profesionistët dhe agjencitë e tjera
- ✓ Fëmija do të ndihmohet që të marrë pjesë në përgatitjen për vendimin për adoptim në përputhshmëri me mundësitë e tij/saj dhe nivelin e pjekurisë
- ✓ Mirëqenia e fëmijës për t'u adoptuar është shqetësimi kryesor por jo i vetmi për shërbimin e adoptimit

- ✓ Për t'u siguruar më mirë se adoptimi do të jetë i suksesshëm, asnjë fëmijë nuk do të vendoset për adoptim brenda familjes me fëmijë të tjerë të moshës që janë më pak se dy vjet me moshën e tij/saj
- ✓ Përshtatja e prindërve adoptues me fëmijën do të bëhet bazuar në nevojat dhe mundësitë e të dy palëve
- ✓ Ruajtja e identitetit kulturor dhe etnik duhet të jetë konsiderimi kryesor kur fëmija konsiderohet për adoptim

Aktivitetet kryesore të shërbimit të adoptimit përfshijnë:

- Identifikimi i fëmijës për t'u adoptuar, sa herë që është e mundur prindit i ofrohen informata lidhur me të drejtat dhe përgjegjësitë, gjatë marrjes pjesë në shërbim. Kjo do të përfshijë
 - Cilat shërbime (më poshtë) do të jenë në disponim për fëmijën dhe kur ka mundësi që shërbimet të ofrohen
 - Si dhe pse mund të përfshihen prindërit në procesin e vlerësimit
- Vlerësimi i fëmijës
 - Gjithnjë me pjesëmarrjen më aktive të fëmijës në përputhshmëri me mundësitë e tij/saj
 - Gjithnjë duke marrë parasysh vlerësimet e tjera ekzistuese
 - I targetuar në vlerësimin e nevojave sociale dhe psikologjike, mundësive dhe sjelljes
 - Prioritizimi i nevojave që kërkojnë mbështetje gjatë dhe pas adoptimit
- Vlerësimi i prindërve adoptues
 - Vlerësimi i nevojave dhe mundësive të aplikuesve
 - Individualisht
 - Si çift
 - Si familje (kur ka fëmijë të tjerë në familje)
 - Vlerësimi i rreziqeve mjedisore, fizike dhe shoqërore
- Planifikimi
 - Krijimi i një plani individual të rastit

- Identifikimi i aktiviteteve për t'u ofruar në përgatitjen për adoptim, që i përmbushin nevojat kryesore të identifikuara të fëmijës dhe prindërve adoptues
 - Vënia e theksit në shkathtësitë praktike ditore të të jetuarit dhe shkathtësive sociale të kërkuara për marrëdhënie pozitive dhe të jetuarit në familje
 - Identifikimi i 'menaxherit të rastit' të ofrojë mbështetje personale për secilin fëmijë për t'u adoptuar
 - Rishikim i rregullt i planit në pajtueshmëri me nevojat e secilit fëmijë individualisht dhe familjes adoptuese ashtu sikur është specifikuar në vetë planin e shërbimit, në qoftë se është me frekuent se standardi minimal funksional
- Zhvillimi dhe mirëmbajtja e shkathtësive praktike ditore të të jetuarit
 - Komunikimi social, adaptimi dhe zhvillimi i marrëdhënieve para se vendosja në adoptim të jetë bërë
 - Programet e menaxhimit të sjelljes sikur kërkohet para se adoptimi të jetë vendosur, duke i shfrytëzuar metodat sa më pak kufizuese, ashtu siç janë specifikuar në planin individual të shërbimit
- Mbikëqyrja dhe mbështetja
 - Mbikëqyrje që siguron një mjedis të sigurt për fëmijën gjatë përgatitjes për adoptim dhe vendosjes për adoptim
 - Detyra specifike të mbikëqyrjes ashtu sikur janë identifikuar në planin individual të rastit bazuar në vlerësimin e rrezikut
- Hapësirat e shërbimit (ndërtesat dhe pajisjet)
 - Ofrimi i ndërtesave që janë të përshtatshme/në përputhshmëri me llojet e aktiviteteve që ofrohen
 - Dekorim dhe pajisje të përshtatshme që ofrojnë intimitet dhe ndarje sipas nevojës

Standardet minimale strukturale	Indikatorët e performancës	Standardet minimale funksionale	Indikatorët e performancës
Secili shërbim i adoptimit duhet të ketë së paku një jurist, një punëtor social, një pedagog, një psikolog dhe një sociolog		Secili fëmijë i konsideruar për adoptim potencial do ta ketë një menaxher të caktuar të rastit	Numri i fëmijëve me menaxherë të caktuar të rastit / numri i fëmijëve
Secili shërbim i adoptimit duhet të ketë qasje tek një mjek i praksës së përgjithshme		Secili fëmijë i konsideruar për adoptim potencial do ta ketë një kujdestar të caktuar ligjor	Numri i fëmijëve me kujdestarë të caktuar ligjor /numri i fëmijëve
Ekipi duhet të ketë qasje tek një punëtor social me përvojë në spital		Në secilin rast të braktisjes, informatat do të ndahen me departamentin e	Numri i rasteve potenciale të braktisjes brenda 24 orëve të

		mirëqenies sociale brenda 24 orëve të referimit të rastit	shpërndarjes fillestare të informacionit / numri i rasteve të braktisjes
Secili menaxher i rastit do t'i ketë maksimum 3 fëmijë për adoptim për çdo vit	Numri i menaxherëve të rastit / numri i fëmijëve /3	Secili fëmijë do ta ketë një plan individual të rastit që do të përgatitet pas vlerësimit fillestar dhe brenda 2 javësh nga referimi i rastit	Numri i rasteve të fëmijëve me planet e përkujdesjes të kompletuara brenda 2 javëve të vlerësimit / numri i fëmijëve të vlerësuar
Secili ekip i shërbimit të adoptimit do të jetë një kombinim i gjinisë, që punëson edhe femra edhe meshkuj		Plani individual i rastit për secilin fëmijë do të rishikohet së paku një herë në muaj	Numri i fëmijëve me planet e përkujdesjes të shqyrtuara në çdo muaj / numri i fëmijëve me planet e përkujdesjes
Një dhomë për intervistim do të jetë në disponim për përdorim të shërbimit gjatë intervistimit të fëmijës, prindërve adoptues dhe prindërve natyral		Vlerësimi i prindërve potencial adoptues dhe familjes do të behet brenda 3 muajve	Numri i prindërve potencial adoptues të vlerësuar gjat periudhës 3 mujore të vlerësimit/numri i prindërve potencial adoptues të vlerësuar
Secili anëtar i ekipit do të ketë qasje në teknologjinë informative e cila e mbështetë punën e ekipit, përfshirë një kompjuter, printer, skaner dhe qasje në internet		Trajnimi i prindërve potencial adoptues dhe i familjes do të bëhet pas vlerësimit dhe bazuar në nevojat e tyre	Numri i prindërve adoptues të trajnuar pas periudhës së vlerësimit / numri i prindërve adoptues të trajnuar
Secili shërbim regjional do të ketë qasje në së paku 2 automjete për ta mbështetur punën e vetë		Së paku dy nga takimet vlerësuese me prindërit adoptues do të bëhen pa paralajmërim paraprak	
Secili shërbim do të ketë buxhet të qartë dhe procedura të qarta për menaxhimin e shpenzimeve brenda atij buxheti		Prindërit adoptues do të intervistohen dhe vlerësohen ndaras, së paku një here gjatë fazës së vlerësimit	
		Fëmijët natyral/biologjik të moshës mbi 10 vjeç, të familjes së prindërve adoptues do të intervistohen ndaras, së paku një herë gjatë fazës së vlerësimit	

		Rivlerësimi i familjeve të aprovuara adoptuese të cilat nuk kanë marrë fëmijë do të bëhet së paku një herë në vit	Numri i rishikimeve të prindërve adoptues të aprovuar tani për një vit, pa u vendosur adoptimi / numri i prindërve adoptues të aprovuar për një vit tani, por pa vendosje të adoptimit
		Secila familje potenciale adoptuese do t'i ketë së paku 3 takime këshilluese lidhur me është të rëndësishme për adoptimin e fëmijut	Numri i familjeve adoptuese që i kanë 3 apo më tepër vizita këshilluese gjatë vlerësimit / numri i familjeve adoptuese të vlerësuara
		Do të jenë së paku 3 vizita për fëmijën në përgatitje për vendosje me familjen adoptuese	Numri i fëmijëve që i kanë 3 apo më shumë takime përgatitore / numri i fëmijëve të cilët i kanë kompletuar përgatitjet për adoptim
		Do të jenë së paku 3 vizita për fëmijën dhe prindërit adoptues gjatë fazës para adoptuese të vendosjes	Numri i fëmijëve dhe familjeve që i kanë 3 or apo më shumë vizita para adoptive / numri i fëmijëve të vendosur për adoptim
		Secili fëmijë do të vizitohet në shtëpinë adoptuese, së paku 2 herë gjatë 12 muajve pasi të jetë marrë vendimi final për adoptim	Numri i fëmijëve që janë vizituar 2 apo më shumë herë brenda 12 muajve / numri i fëmijëve të adoptuar

Shërbimi	No Ref 3 - Adoptimi i fëmijëve pa përkujdesje prindërore
Ofruesi i shërbimit	
Qyteti	Aktual
Personi ndërlidhës - rishikimi i të dhënave të mbledhura	
Data e rishikimit	

Nr.Ref	Standardet minimale strukturore	Indikatori i performancës	Aktual	I kërkuar	Niveli i përshtatshmërisë	Metoda e monitorimit			P/J	Arsyeja për mosarritje (sipas kodit)	Propozimi sipas kodit
						Mdh	M	O			
3.1.1	Secili shërbim i adoptimit duhet të ketë së paku një psikolog, një punëtor social, një jurist, një pedagog dhe një sociolog		2	4	50.00%						
3.1.2	Secili shërbim i adoptimit duhet të ketë qasje tek një mjek										
3.1.3	Shërbimi i adoptimit duhet të ketë qasje tek një punëtor social me përvojë që është i punësuar në repartin përkatës spital										
3.1.4	Secili menaxher i rastit do t'i ketë maksimum 3 fëmijë për adoptim në secilin vit	Numri i menaxhereve të rastit / numri i fëmijëve /3									
3.1.5	Secili shërbim i adoptimit do të jetë i përzier sa i përket gjinisë, duke punësuar edhe meshkuj edhe femra										

3.1.6	Secila QPS duhet të ketë së paku një dhomë për intervistim në disponim për përdorim nga shërbimi për intervistimin e fëmijëve, prindërve adoptues dhe prindërve natyral																		
3.1.7	Secili anëtar i shërbimit do të ketë qasje në teknologjinë informative, që e mbështet punën e ekipit, përfshirë kompjuterin, printerin, skanerin dhe qasjen në internet																		
3.1.8	Shërbimi i adoptimit në qendrat regjionale do të ketë qasje në së paku 2 vetura për ta mbështetur punën e shërbimit																		
3.1.9	Shërbimi i adoptimit në komunat e vogla do të ketë qasje në së paku 1 veturë për ta mbështetur punën e shërbimit																		
3.1.10																			
Nr Ref	Standardet specifike minimale funksionale	Indikatori i performancës																	
3.2.1	Secili fëmijë potencial për adoptim do ta ketë menaxherin e caktuar të rastit	Numri i fëmijëve me menaxherë të caktuar të rastit / numri i fëmijëve																	
3.2.2	Secili fëmijë potencial për adoptim do ta ketë një kujdestar ligjor të caktuar	Numri i fëmijëve me kujdestar të caktuar ligjor / numri i fëmijëve																	
3.2.3	Ne secilin rast potencial të braktisjes, informacioni do të ndahet me Departamentin e Mirëqenies Sociale brenda 24 orëve prej momentit të referimit të rastit	Numri i rasteve të braktisjeve me shpërndarje të informatave brenda 24 orëve / numri i rasteve të braktisjes																	

3.2.4	Secili rast duhet ta ketë një plan të punës që do të përgatitet pas një vlerësimi fillestar dhe brenda 2 javëve të referimit	Numri i fëmijëve me planet e përkujdesjes të kryera brenda 2 javëve të vlerësimit / numri i fëmijëve të vlerësuar										
3.2.5	Plani individual i rastit për secilin fëmijë do të rishikohet së paku një here në muaj	Numri i fëmijëve me plane mujore të rishikuara të përkujdesjes / numri i fëmijëve me plane të përkujdesjes										
3.2.6	Vlerësimi i prindërve potencial adoptues dhe familjes do të kryhet brenda 3 muajve	Numri i prindërve adoptues i vlerësuar gjatë periudhës 3 mujore të vlerësimit / numri i prindërve adoptues të vlerësuar										
3.2.7	Trajnimi i prindërve potencial adoptues dhe familjes do të kryhet pas vlerësimit fillestar bazuar në nevojat e tyre											
3.2.8	Se paku dy nga takimet vlerësuese me prindërit adoptues do të bëhen pa paralajmërime paraprake											
3.2.9	Prindërit adoptues do të intervistohen dhe vlerësohen ndaras së paku një herë gjatë fazës së vlerësimit											
3.2.10	Fëmijët e tjerë mbi 10 vjet brenda familjes së prindërve adoptues do të intervistohen ndaras së paku një herë gjatë fazës së vlerësimit											

3.2.11	Rivlerësimi i prindërve të aprovuar adoptues të cilët ende nuk kanë marrë fëmijë do të bëhet së paku një herë në vit	Numri i rivlerësimeve të prindërve të aprovuar adoptues pa vendosje të fëmijët për një vit / numri i prindërve të aprovuar adoptues për një vit pa vendosje të fëmijës												
3.2.12	Secila familje potenciale adoptuese do t'i ketë së paku 3 seanca këshilluese lidhur me çështje të rëndësishme që kanë të bëjnë me adoptimin e fëmijës	Numri i familjeve adoptuese të cilat kanë marrë pjesë në 3 apo më shumë seanca këshilluese gjatë vlerësimit / numri i familjeve të vlerësuara adoptuese												
3.2.13	Do të jenë së paku 3 vizita për fëmijën në përgatitje për vendosje me familjen adoptuese	Numri i fëmijëve të cilët kanë marrë pjesë në 3 apo më shumë seanca përgatitore / numri i fëmijëve që i kanë kryer përgatitjet për adoptim												
3.2.14	Do të bëhen së paku 3 vizita të fëmija dhe prindërit adoptues gjatë fazës paraadoptuese të vendosjes	Numri i fëmijëve dhe familjeve adoptuese që i kanë pasur 3 apo më shumë vizita paraadoptuese / numri i fëmijëve të vendosur për adoptim												

Legjenda

MDh	Mbledhja e të dhënave - metoda e cila përdorë indikatorët e performancës për ofrimin e informatave
M	Mbikëqyrja - metoda e cila e përcakton përshtatshmërinë përmes mbikëqyrjes së stafit
O	Observimi - ne realitet ky është inspektimi
J Kodet	Arsyeja për mospërshtatshmëri apo përshtatshmëri të pjesshme me standardet
J1	Koha jo e mjaftueshme e kaluar me shfrytëzuesin e shërbimit
J2	Mungesa e stafit
J3	Shkathtësitë e reja të kërkuara nga stafi
J4	Bashkërendimi i dobët me agjencitë e tjera
J5	Planifikimi i dobët i shërbimeve
J6	Mbikëqyrje jo e mjaftueshme
J7	Bashkëpunim me ndërprerje me shfrytëzuesin e shërbimit
J8	Hapësira të papërshtatshme për ofrimin e shërbimit
J9	Burime të pamjaftueshme financiare
J10	Mungesa e procedurave të brendshme që lejojnë matjen e përshtatshmërisë
J11	Standard joreal dhe jo i arritshëm
J12	Shëndeti i dobët i klientit
J13	Vdekja e shfrytëzuesit të shërbimit
J14	Tjera – të lutem numëro
R Kodet	Veprimi i propozuar i ofruesit (Reagimi) pas jo përshtatshmërisë me standardin
R1	Amendament për ta bërë standardin më real
R2	Përmirësim i shkathtësive të profesionistëve për ta arritur standardin
R3	Sisteme të përmirësuara për ta matur përshtatshmërinë
R4	Bashkërendim më i mirë me agjencitë e tjera
R5	Sisteme të përmirësuara të planifikimit të shërbimeve
R6	Mbikëqyrje e përmirësuar
R7	Vlerësim më i mirë për të siguruar bashkëpunimin me shfrytëzuesin e shërbimit
R8	Hapësira fizike të përmirësuara për ofrimin e shërbimeve
R9	Burime të shtuara financiare
R10	Programe të reja trajnuese për t'u krijuar apo akredituar